

VENDIM
Nr.1304, datë 24.9.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS LESKOVIK, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Leskovik, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Leskovik, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.501, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Leskovik, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Leskovik për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Leskovik

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
4,5,10,18-19,24,29,34,39,44,49,54,58,67	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
6,7,8,9,11-17,20-23,25-28,30-33,35-38,40-43,45-48,50-53,55-57,59-66,68-71,72-77	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka improduktive, kanale të treta) dhe objekte të ish-NB	Në pronësi
79-93	Shërbim funeral	Në pronësi
94	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
95-105	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
106	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
713-743	Infrastrukturë rrugore	Në pronësi
771-780	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi